

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Daimler Truck AG, me seli të regjistruar në Fasanenweg 10, 70771 Leinfelden-Echterdingen, Gjermani, të dorëzuar përmes Filip Zafriovskit, avokat nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 25.03.2026, mori këtë:

### **AKTVENDIM**

1. Konstatohet se përqendrimi me të cilin Daimler Truck AG, me seli të regjistruar në Fasanenweg 10, 70771 Leinfelden-Echterdingen, Gjermani, ka për qëllim të fitojë kontroll të vetëm mbi Estar Truck and Van Limited, me seli të regjistruar në Unit 3 Alchemy Way, Alchemy Business Park, Knowsley, Angli, L33 7AQ, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose cenimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

2. Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 151/21), në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi dhe programi i të ardhurave 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e këtij aktvendimi.

### **A r s y e t i m**

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më 06.02.2026, ndërsa e plotësuar më 13.02.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), u dorëzua njoftim për përqendrim nga Daimler Truck AG, me seli të regjistruar në Fasanenweg 10, 70771 Leinfelden-Echterdingen, Gjermani, me të cilin Daimler Truck AG ka për qëllim të fitojë kontroll të vetëm mbi Estar Truck and Van Limited, me seli të regjistruar në Unit 3 Alchemy Way, Alchemy Business Park, Knowsley, Angli, L33 7AQ, nëpërmjet shitblerjes së pjesëmarrjeve.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe, në bazë të të dhënave të paraqitura në Njoftimin për përqendrim dhe shtojcave të bashkangjitura, konstatoi si vijon:

### **Aktivitetet themelore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:**

Daimler Truck AG është pjesë e Grupit Daimler.

Daimler Truck AG është aktiv në veprimtarinë e kamionëve dhe autobusëve dhe është i përqendruar në prodhimin dhe shitjen e kamionëve dhe autobusëve. Gama e produkteve të Daimler Truck AG për kamionë përfshin kamionë të lehtë, të mesëm dhe të rëndë për distanca të gjata, shpërndarje dhe transport për kantierë ndërtimi, si dhe automjete speciale që përdoren kryesisht për nevoja komunale.

Daimler Truck AG nuk kontrollon asnjë shoqëri të varur në Maqedoninë e Veriut, ndërsa produktet e tij shpërndahen nga distributori i pavarur – palë e tretë e Grupit Daimler në Maqedoninë e Veriut.

**Estar Truck and Van Limited** posedon sallone për kamionë dhe furgonë të markës Mercedes-Benz dhe Mitsubishi Fuso në veriperëndim të Anglisë dhe në Uellsin Verior.

Estar Truck and Van Limited nuk ka shoqëri të varura, filiale apo përfaqësi të vendosura në Maqedoninë e Veriut dhe nuk ka aktivitete apo qarkullim në Maqedoninë e Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i paraqitur bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit.

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

**Udhëzim për mjetin juridik:**

Kundër këtij aktvendimi mund të ngrihet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimin të aktvendimit.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS  
KRYETARE**

**Mr. Малинка Силјановска Николиќ**